



RAPORTI MONITORIMIT TË VARFËRISË ENERGJITIKE

BASHKIA MEMALIAJ DHE SELENICË



Përmbajtje

1.	Hyrje	1
2.	Demografia dhe kushtet sociale-ekonomike	2
2.1	Bashkia Memaliaj	2
2.2	Bashkia Selenicë	4
3.	Kuadri konceptual dhe strategjia e studimit	5
4.	Metodologjia e studimit	7
5.	Rezultatet	10
5.1.	Tipologjite familjare dhe karakteristikat a banesave	10
5.2	Vlerësimi i Varfërisë Energjetike përmes IVED	12
5.2.1	Bashkia Memaliaj	12
5.2.2	Bashkia Selenicë	15
5.3.	Krahasimi i treguesve të varfërisë energjitike në shumë dimensione me literature ndërkombëtare	18
6.	Konkluzionet dhe rekomandimet	20
7.	ANEKS 1: Moduli për monitorimin dhe analizën e varfërisë energjitike	22

Lista e tabelave

Tabelë 1 Zonat e monitorimit	8
Tabelë 2 Lista e indikatorëve të analizuar	9
Tabelë 3 Dimensionet dhe indikatorët e pëdorur për analizën e varfërisë energjitike në shumë dimensione	10
Tabelë 4 Struktura familjare dhe kushtet e banimit në Memaliaj dhe Selenicë	11
Tabelë 5 Të ardhurat & kostot e energjisë për bashkinë Memaliaj dhe Selenicë	12
Tabelë 6 Treguesit e indeksit të varfërisë energjitike për bashkitë e marra në studim dhe vlerat referencë	18
Tabelë 7 Vlerat referencë të indeksit të varfërisë energjitike për Ballkanin	18

Lista e grafikëve

Grafik 1 Burimi i të ardhurave, Memaliaj	3
Grafik 2 Sektorët e punësimit, Memaliaj	3
Grafik 3 Niveli arsimor, Memaliaj	4
Grafik 4 Sektorët e punësimit, Selenicë	5
Grafik 5 Struktura metodologjike e indeksit të varfërisë energjitike në shumë dimensione	6
Grafik 6 Shpërndarja e individëve jo të privuar dhe të privuar sipas indikatorëve, Bashkia Memaliaj	13
Grafik 7 Treguesit e IVED, Bashkia Memaliaj	14
Grafik 8 Kontributi i dimensioneve, Memaliaj	15
Grafik 9 Shpërndarja e individëve jo të privuar dhe të privuar sipas indikatorëve, Bashkia Selenicë	16
Grafik 10 Treguesit e IVED, Bashkia Selenicë	17
Grafik 11 Kontributi i dimensioneve, Selenicë	17
Grafik 12 Vlerat e treguesve të indeksit të varfërisë energjitike në shumë dimensione	19

Lista e akronimeve

IVED	Indeksi i varfërisë energjitike në shumë dimensione
AF	Metodologjia Alkire-Foster

1. Hyrje

Varfëria energjetike përkufizohet gjerësisht si paaftësia e familjeve për të siguruar një nivel komforti të nevojshme për një standard minimal jetese, përfshirë ngrohjen, ftohjen, ndriçimin dhe përdorimin e pajisjeve bazë shtëpiake. Ky fenomen është rezultat i ndërveprimit kompleks midis faktorëve ekonomikë (të ardhurat e ulëta), faktorëve mbi cilësinë e ndërtesave (eficienca e ulët energjetike e banesave) dhe faktorëve të tregut (çmimet e larta të energjisë). Referuar literaturës së huaj, varfëria energjetike trajtohet si një koncept shumëdimensional, i cili nuk mund të kufizohet vetëm në një tregues të vetëm.¹ Qasjet bazuar vetëm në një tregues, (psh bazuar vetëm në raportin e shpenzimeve për energji ndaj të ardhurave), janë kritikuar për kufizimet e tyre në vlerësimin e plotë të fenomenit. Studimet theksojnë rëndësinë e integritetit të dimensioneve të tilla si cilësia e ndërtesës, aksesit në energji dhe përballueshmëria ekonomike, duke reflektuar më mirë realitetin e privimeve të përjetuara nga familjet.² Në Shqipëri janë realizuar disa studime mbi vlerësimin e nivelit të varfërisë energjetike por deri më tani ato kanë qenë bazuar vetëm në një tregues duke limituar vlerësimin e plotë të fenomenit. Bazuar në raportin e fundit nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë³, Shqipëria akoma nuk ka një përkufizim mbi varferinë energjetike dhe nuk ka një sistem të plotë të monitorimit të saj. Ndërkohë, referuar Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës⁴, Shqipëria duhet të ndërtojë një sistem të monitorimit të varfërisë energjetike dhe të përcaktojë një përkufizim për vlerësimin e varfërisë energjetike. Qëllimi i këtij studimi është për të vlerësuar nivelin e varfërisë energjetike nga shumë dimensione në Bashkinë Memaliaj dhe Selenicë nëpërmjet Indeksit të varfërisë energjetike në shume dimension (IVED)⁵. Ndërkohë metodologjia e zhvilluar nga ky studim mund të kontribuojë në institucionalizmin dhe integrimin e saj në legjislacionin aktual ku të përdoret për vlerësimin e varfërisë energjetike në nivel lokal dhe kombëtar. **Në mënyrë më specifike, studimi synon të identifikojë i) Përqindjen e familjeve që klasifikohen të varfër nga aspekti energjetik (incidenca) ii) shkallën e privimit (intensiteti ose ashpërsia), ose thënë ndryshe sa të varfër janë komunitetet, si dhe të llogarisë nivelin e përgjithshëm të varfërisë energjetike për secilën bashki.** Një fokus i veçantë i studimit është analiza e kontributit të secilit dimension në formësimin e varfërisë energjetike, me qëllim identifikimin e faktorëve dominues që ndikojnë në këtë fenomen. Përmes kësaj analize synohet të evidentohet se cilët indikatorë dhe dimensione ndikojnë më tepër në nivelin e varfërisë energjetike. Studimi fokusohet në bashkitë Memaliaj dhe Selenicë, dy zona me karakter kryesisht rural në jug të Shqipërisë, të cilat karakterizohen nga të ardhura të ulëta, ekonomi të bazuar në bujqësi dhe akses i kufizuar në shërbime. Këto karakteristika i bëjnë ato veçanërisht të ekspozuara ndaj varfërisë energjetike, duke ofruar një bazë të përshtatshme për analizë krahasuese. Metodologjia bazohet në Indeksin e Varfërisë Energjetike në shumë dimensione (IVED), sipas qasjes Alkire–Foster. Analiza përfshin tre dimensione kryesore: kushtet e ndërtesës, aksesin në energji dhe kushtet socio-ekonomike, të ndara në 10 indikatorë kryesor. Të dhënat janë mbledhur përmes anketimit të rreth 100 familjeve në secilën bashki dhe janë analizuar përmes një matrice binare të privimeve, duke përdorur kufirin $k = 0.3$ për identifikimin e familjeve të varfra energjetikisht. Në vijim janë llogaritur treguesit

¹ [Domestic energy deprivation](#)

² [Measuring and monitoring energy poverty in the EU - examples of good practices](#)

³ <https://eee.energy-community.org/nees/Energy-Community-Nees/2024/10/10a.html>

⁴ [https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_811_The-National-Energy-and-Climate-Plan-\(NECP\).pdf](https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_811_The-National-Energy-and-Climate-Plan-(NECP).pdf)

⁵ <https://eee.mdpi.com/2071-1050/5/5/2060>

kryesorë: incidenca, intensiteti dhe indeksi IVED. Rezultatet e studimit tregojnë se varfëria energjetike në Bashkitë Memaliaj dhe Selenicë paraqitet në nivele shumë të larta, si në aspektin e përhapjes ashtu edhe të intensitetit të varfërisë energjetike. Analiza e realizuar përmes Indeksit të Varfërisë Energjetike në Shumë Dimensione (IVED) tregon se incidenca e varfërisë energjetike arrin në 99% në Bashkinë Memaliaj dhe 98% në Bashkinë Selenicë, kjo tregon se pothuajse e gjithë popullsia e përfshirë në studim përjeton privime energjetike në më shumë se një dimension. Analiza sipas dimensioneve tregon se kushtet e banesës përbëjnë faktorët kryesorë që ndikojnë në nivelin e varfërisë energjetike, me një kontribut prej 45% në Memaliaj dhe 46% në Selenicë. Problematikat më të theksuara lidhen me mungesën e izolimit termik, praninë e lagështirës dhe moshën e ndërtesave. Krahasimi me literaturën ndërkombëtare evidenton se vlerat e indeksit IVED në këto bashki tejkalojnë ndjeshëm nivelet tipike të raportuara në vende të tjera, duke nënvizuar nevojën për ndërhyrje të menjëhershme dhe të targetuara. Rekomandimet e familjeve fokusohen kryesisht në përmirësimin e kushteve të banesave përmes izolimit termik, riparimit të çatave, eliminimit të lagështirës dhe zëvendësimit të pajisjeve joeficiente. Familjet kërkojnë gjithashtu mbështetje financiare për përdorimin e pajisjeve më eficiente për ngrohje dhe ftohje, instalimin e paneleve diellore dhe rehabilitimin energjetik të banesave. Një tjetër prioritet lidhet me përmirësimin e furnizimit me energji dhe investimet në rrjetin e shpërndarjes. Në aspektin socio-ekonomik, rekomandimet përfshijnë forcimin e mbështetjes financiare për familjet vulnerabël, edukimin mbi kursimin e energjisë dhe krijimin e skemave lehtësuese për fermerët dhe grupet më të prekura.


2. Demografia dhe kushtet sociale-ekonomike

2.1 Bashkia Memaliaj


Bashkia Memaliaj ndodhet në jug të Shqipërisë, në qarkun e Gjirokastrës, duke zënë një pozicion të rëndësishëm gjeografik përgjatë luginës së lumit Vjosa. Bashkia Memaliaj e krijuar me reformën territoriale të vitit 2015 duke bashkuar disa njësi të mëparshme si Memaliaj, Memaliaj Fshat, Luftinjë, Buz, Krahës dhe Qesarat, ku qendra administrative është qyteti i Memaliajt. Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 10.657 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki ka 21.476 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 372.07 km² me një densitet prej 78.90 banorë/km². Aktiviteti kryesor ekonomik i Bashkisë është i përqendruar kryesisht në bujqësi dhe blegtori, dhe më pak në shërbime të vogla tregtare. Bashkia Memaliaj bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare, me ndikime të lehta kontinentale për shkak të relievit kodrinor dhe malor. Bashkia Memaliaj ndodhet në zonën klimaterike II duke përcaktuar si zone e ekspozuar ndaj ndryshimeve të klimës. Këto zona karakterizohen nga vera të nxehta dhe të thata dhe dimra të butë në luginë, por më të ftohtë në zonat më të larta. Kjo e bën klimën e Memaliajt një variant të klimës mesdhetare të modifikuar nga relievi. Aktiviteti kryesor ekonomik i Bashkisë është i përqendruar kryesisht në bujqësi dhe blegtori, dhe më pak në shërbime të vogla tregtare. Papunësia në Bashkinë Memaliaj është rreth 21% (sipas Censurit të vitit 2011). Shkalla e papunësisë në këtë bashki është rreth 30% më e ulët se mesatarja kombëtare. Nga ana tjetër, të dhënat aktuale të mbledhura nga Bashkia Memaliaj flasin për nivele papunësie rreth 40–45% në total. Ndër banorët e punësuar, 50% punojnë në bujqësi, të ndjekur nga shërbimet me 38.2% dhe industria me 11.8%. Burimet kryesore të të ardhurave të familjeve janë punësimi me pagesë ose vetëpunësimi (44.3%) dhe pensionet (41.6%), të ndjekura nga ndihma sociale dhe përfitimet (13.9%) dhe remitancat (7.4%). Pjesa e lartë e të ardhurave nga pensionet reflekton strukturën kryesisht të moshuar të popullsisë në zonë. Ndihma sociale dhe skemat e tjera të ngjashme të mbështetjes përbëjnë 13.9% të të ardhurave të familjeve të popullsisë lokale në Memaliaj, ndërsa remitancat përfaqësojnë 7.4%

të të ardhurave totale. Burimi kryesor i të ardhurave familjare është punësimi dhe vetëpunësimi, të cilat së bashku përbëjnë më pak se gjysmën e totalit, me 44.3% ⁶.

Familjet me kryefamiljar gra në Bashkinë e Memaliajt përbëjnë rreth 11% të të gjitha familjeve, një shifër më e ulët se mesatarja kombëtare prej 14.2%. Të dhënat mbi numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike shërbejnë si një tregues indirekt i nivelit të varfërisë në Memaliaj. Kjo mbështetje ofrohet për gjithsej 590 familje, nga të cilat rreth 200 ndodhen në qytetin e Memaliajt. Krahësuar me numrin e përgjithshëm të familjeve, rreth 10% përfitojnë nga kjo ndihmë.



Grafik 1 Burimi i të ardhurave, Memaliaj




Grafik 2 Sektorët e punësimit, Memaliaj

⁶

[Royal HaskoningDHV & EMA Consulting. \(2018\). Environmental and Social Health Impact Assessment \(ESHIA\) Report for 2D Seismic Survey Block 4 ëith extension into Blocks 2 and 3. Shell Albania.](#)

Të dhënat mbi nivelin arsimor tregojnë se 60.1% e popullsisë ka përfunduar vetëm arsimin fillor; 26.4% kanë përfunduar arsimin e mesëm, ndërsa 7.2% kanë përfunduar arsimin universitar dhe pasuniversitar⁷. Niveli i ulët i arsimit ndikon drejtpërdrejt tek niveli i ndërgjegjësimit dhe informimit mbi shkaqet dhe mënyrat e adresimit të varfërisë energjitike. Rreth 50% e popullsisë lokale është e punësuar në sektorin e bujqësisë shoqëruar nga 38% në sektorin e shërbimeve dhe rreth 12% në industri. Siç shikohet, një pjesë e konsiderueshme punon në sektorin e bujqësisë e cila lidhet drejtpërdrejt me konsumin e lartë të energjisë për pompat me ujë dhe lëndet djegëse që përdoren.



Grafik 3 Niveli arsimor, Memaliaj

2.2 Bashkia Selenicë

Bashkia Selenicë ndodhet në jug të Shqipërisë, në qarkun e Vlorës, dhe shtrihet përgjatë luginës së lumit Vjosa dhe degëve të saj. Territori i saj karakterizohet nga një reliev i larmishëm, ku ndërthuren zona fushore, kodrinore dhe malore, duke krijuar një peizazh të thyer dhe të pasur natyror. Pozicioni gjeografik i Selenicës e vendos atë si një zonë lidhëse mes zonës bregdetare të Vlorës dhe brendësisë malore të jugut të Shqipërisë. Sipas Censusit të vitit 2011, zona e bashkisë së re Selenicë ka një popullsi prej 18.476 banorësh ndërsa në Regjistrin Civil rezultojnë me 35.793 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 561.24 km² dhe me densitet popullsie 63.77 banorë/km². Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative: Selenicë, Armen, Brataj, Kotë, Llakatund dhe Sevaster. Sipas të dhënave nga Plan i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Selenicë⁸ vetëm 35% e vendbanimeve ndodhen brenda një distance funksionale nga qendra e bashkisë, duke treguar se pjesa dërrmuese e popullsisë rurale jeton jashtë perimetrit efektiv për ofrimin e shërbimeve bazë publike. Kjo ndarje territoriale rrit varësinë nga qendra urbane dhe krijon një disbalancë midis kapaciteteve ekzistuese administrative dhe nevojës për të zgjeruar infrastrukturën dhe logjistikën në zonat e largëta. Bashkia Selenicë bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare, me verë të nxehtë dhe të thatë dhe dimër të butë e relativisht të lagësht.

⁷


<https://star2lgm.idradigis.al/en/bashkite/memaliaj/>

⁸

[Palni i Përgjithshëm Vendor Bashkia Selenicë](#)

Megjithatë, për shkak të relievit kodrinor dhe ndikimit të maleve përreth, klima shfaq edhe nuanca kontinentale, sidomos në zonat më të larta ku temperaturat janë më të ulëta dhe reshjet më të shpeshta. Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, bujqësia dhe blegtoria shërbejnë si burimi kryesor i jetesës për shumicën e popullsisë rurale. Struktura hapësinore e Bashkisë së Selenicës pasqyron një dominim të qartë të zonave natyrore të mbrojtura dhe atyre me përdorim të gjerë të tokës, si pyjet dhe kullotat. Sipas të dhënave të disponueshme, rreth 51% e territorit është i mbuluar nga zona pyjore dhe kullota natyrore, gjë që reflekton karakterin malor dhe kodrinor të bashkisë, si dhe kufizimet për zhvillim intensiv bujqësor. Këto hapësira pyjore përballen me presion të konsiderueshëm antropogjen, i lidhur kryesisht me përdorimin e drurit për ngrohje. Toka bujqësore zë vetëm 29.4% të sipërfaqes totale, një pjesë e konsiderueshme e së cilës është e përqendruar në zonat kodrinore me akses më të lehtë dhe në ultësirat përreth qendrave të njësive administrative si Sevaster dhe Armen.

Punësimi dhe shpërndarja e të punësuarve në Bashkinë e Selenicës, sipas Censurit të vitit 2011, llogariten bazuar në tre sektorët më të rëndësishëm: sektori industrial me 26.7%, sektori i bujqësisë me 31.1% dhe sektori i shërbimeve me 60.2%. Këto të dhëna tregojnë jo vetëm nivelin e punësimit, por edhe karakterin e çdo zone që përbën Bashkinë e Selenicës. Përqindja më e lartë e punësimit është në bujqësi dhe në qytetin e Selenicës (miniera e Selenicës). Njësitë administrative me nivelin më të ulët të punësimit, të cilat evidentojnë gjithashtu pabarazi të rëndësishme sociale, janë njësitë administrative Brataj dhe Vllahinë. Kjo shpërndarje pasqyron gjithashtu karakterin bujqësor dhe blegtoral të popullsisë së punësuar në sektorin e bujqësisë, të dhëna që dëshmojnë natyrën rurale të këtyre njësive.



Grafik 4 Sektorët e punësimit, Selenicë

3. Kuadri konceptual dhe strategjia e studimit

Varfëria energjitike përkufizohet si kushtet kur një familje nuk arrin të sigurojë energji të mjaftueshme për nevojat bazë të jetesës, si ngrohja, ftohja dhe ndriçimi, për shkak të të ardhurave të ulëta, çmimeve të larta të energjisë dhe efikasitetit të dobët të banesave. Sipas studimeve nga Organizata për zhvillim dhe bashkpunim ekonomik⁹ tregojnë se rreth 20–40%

⁹

[Energy prices and subsidies in Albania](#)

e familjeve përballen me vështirësi për të përballuar kostot e energjisë ose për të mbajtur banesat ngrohtë gjatë dimrit, duke e bërë Shqipërinë një nga vendet më të ekspozuara në rajon ndaj këtij fenomeni.

Në legjislacionin shqiptar nuk ekziston ende një përkufizim i unifikuar ligjor për “varfërinë energjetike”. Fenomeni trajtohet kryesisht në mënyrë indirekte përmes skemave të ndihmës sociale, subvencioneve për konsumatorët vulnerabël dhe granteve periodike të cilat shpesh herë nuk arrijnë deri tek përfituesit final.

Sipas literaturës, varfëria energjetike nuk mund të matet në mënyrë të plotë vetëm përmes të ardhurave ose shpenzimeve për energji, por duhet të trajtohet si një fenomen shumë dimensional që përfshin kushtet e banimit, aksesin në energji dhe faktorët socio-ekonomikë¹⁰. Në Shqipëri, studimet që janë realizuar për varfërinë energjetike janë bazuar kryesisht vetëm tek 1 (një) indikator duke mos pasqyruar në mënyrë të plotë shpërndarjen por edhe ashpërsinë e varfërisë energjetike. Indeksi Varfërisë Energjetike në shumë dimensione (IVED) është një metodë që mat varfërinë energjetike duke kombinuar disa dimensione të privimit në nivel familjar. Ajo bazohet në qasjen metodologjike të **Alkire–Foster**, e cila lejon vlerësimin jo vetëm të pranisë së varfërisë, por edhe intensitetit ose ashpërsisë së saj. Kjo metodologji lejon që rezultatet të interpretohen në mënyrë më të thelluar sesa një analizë tradicionale bazuar në një indikator. Në vend që varfëria energjetike të shihet si një gjendje binare (po/jo), IVED e trajton atë si një spektër, ku familjet mund të kenë nivele të ndryshme ekspozimi dhe privimi ndaj shumë dimensioneve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekste si Shqipëria, ku faktorët mbi ndërtesën ose strukturore (cilësia e banesave), ekonomikë (të ardhurat) dhe energjetikë (akses/furnizim) ndërveprojnë në mënyrë të ndërlikuar me njëra tjetrën. Metoda IVED është një qasje e matjes së varfërisë nga shumë dimensione që identifikon individët/familjet e varfra përmes dy hapave: Identifikimi i privimeve në secilin indikator, përcaktimi i varfërisë përmes një pragu të përgjithshëm (k).



Grafik 5 Struktura metodologjike e indeksit të varfërisë energjetike në shumë dimensione

Grafiku paraqet strukturën metodologjike të përdorur për matjen e varfërisë energjetike në shumë dimensione, duke integruar tre dimensione themelore: kushtet e ndërtesës, aksesin në

10

[binary](#)

[A global perspective on domestic energy deprivation: Overcoming the energy poverty–fuel poverty](#)

energji dhe kushtet socio-ekonomike. Secili dimension operacionalizohet përmes indikatorëve përkatës, ndërsa vlerësimi përfundimtar realizohet nëpërmjet treguesve standardë të IVED: incidenca (H), intensiteti (A) dhe indeksi i përbërë (M_0). Kjo qasje mundëson identifikimin e familjeve të prekura dhe vlerësimin e shkallës së privimit energjistik nga më tepër se një dimension.

Konceptet bazë të metodologjisë Alkire–Foster.

- 1. Dimensionet** përfaqësojnë fushat kryesore të mirëqenies energjetike (p.sh. akses, cilësi, përballueshmëri). Çdo dimension pasqyron një aspekt konceptual të varfërisë energjetike.
- 2. Indikatorët** janë variabla specifike brenda çdo dimensionit që matin privime konkrete (p.sh. mungesa e energjisë elektrike, përdorimi i karburanteve ndotëse, apo shpenzimet e larta për energji).
- 3. Peshat:** Çdo dimension dhe indikator mund të ketë peshë të barabartë ose të diferencuar, në varësi të rëndësisë së tyre në analizë. Në shumë aplikime, përdoret peshëzim i barabartë për thjeshtësi dhe transparencë.
- 4. Kufiri i indikatorëve:** përcakton nëse një familje është e privuar në një indikator të caktuar. Në këtë rast përdoret një kodim binar, ku **0 tregon mungesë privimi** dhe **1 tregon ekzistencën e privimit**. Këto pragje varen nga konteksti i vendit dhe të dhënat empirike.
- 5. Kufiri i varfërisë (k):** përcakton numrin minimal të privimeve të peshuara që një familje duhet të ketë për t'u konsideruar e varfër energjetikisht. Sipas literaturës nëse rezultati i privimit është më i madh ose i barabartë me **0.3**, familja klasifikohet si e varfër¹¹.
- 6. Rezultati i privimit (c_i):** përfaqëson masën totale të privimeve që përjeton një familje në të gjitha indikatorët e përfshirë në analizë. Ai llogaritet duke agreguar vlerat binare të privimit (0 dhe 1), të peshuara sipas rëndësisë së çdo indikatorit ose dimensionit.
- 7. Incidenca (H)** përfaqëson përqindjen e njerëzve (brenda një popullsie të caktuar) që përjetojnë varfëri energjetike në shumë dimensioneose thënë ndryshe sa % e popullsisë është e varfër energjetikisht.
- 8. Intensiteti (A)** tregon shkallën (ose ashpërsinë) e privimeve që përjetojnë personat e varfër (brenda një popullsie të caktuar), ose thënë ndryshe sa të varfër janë popullsia e targetuar.
- 9. Indeksi IVED (M_0)** Matësi përfundimtar i varfërisë energjetike shumëdimensionale, i cili llogaritet si: $M_0 = H \times A$ dhe reflekton si përhapjen, ashtu edhe intensitetin e varfërisë në një popullatë të përcaktuar.

4. Metodologjia e studimit

Metodologjia e këtij studimi bazohet në një proces të strukturuar të përzgjedhjes së indikatorëve për ndërtimin e një moduli për monitorimin dhe analizën e varfërisë energjetike. Indikatorët janë përzgjedhur dhe përshtatur duke u mbështetur në qasjen e rekomanduar nga Observatori për Këshillimin ndaj Varfërisë Energjetike¹² duke i organizuar ato në tre dimensione kryesore:


- **Dimensioni i kushteve të ndërtesës** vlerëson kushtet fizike dhe strukturore që ndikojnë në performancën e energjisë;
- **Dimensioni mbi aksesin në energji** vlerëson aksesin dhe përdorimin real të energjisë për të plotësuar kushtet e komfortit;
- **Dimensioni mbi kushtet socio-ekonomike** vlerëson aftësinë financiare të familjeve për të përballuar kostot e energjisë;

¹¹ [Unstacking global poverty: Data for high-impact action](#)

¹² <https://energy-poverty.ec.europa.eu/observatory>

Gjatë periudhës Janar–Shkurt 2026, është realizuar mbledhja e të dhënave përmes pyetësorëve me 100 familje në secilën bashki. Pyetësorët janë plotësuar në formë vetë-raportimi nga familjet, ndërsa procesi është mbështetur nga këshilluesit e energjisë. Përzgjedhja e familjeve është realizuar në bashkpunim me përfaqësues nga Bashkia Memaliaj dhe Selenice të cilët i kanë dhënë prioritet familjeve që marrin asistencë sociale dhe më pas kanë orjentuar këshilluesit e energjisë të marrin të dhëna nga njësitë e tjera administrativ. Në hartën e mëposhtme janë paraqitur zonat ky është kryer monitorimi.

Figure 1 Harta e zonave të monitorimit të varfërisë energjetike



Është bërë një balancë e të dhënave ndërmjet zonave urbane dhe ato rurale por duke konsidruar kontekstin lokal kjo ndarje nuk përbën ndonjë diferencë në rezultatin e të dhënave. Metodologjia mbështetet në kornizën Alkire–Foster¹³, e cila është gjerësisht e përdorur në literaturën ndërkombëtare për matjen e varfërisë energjetike në shumë dimensione dhe është përshtatur në mënyrë të veçantë për analizën e varfërisë energjetike në studime të ndryshme. Kjo metodologji është një risi për Shqipërinë dhe vlen si një instrument e cila mund të integrohet si një model për të realizuar monitorimin e varfërisë energjetike në të gjithë vendin. Modeli aktual i monitorimit të varfërisë së energjisë nuk jep një panoramë të qartë mbi nivelin e varfërisë së energjisë në komunitete pasi ai bazohet vetëm tek një indikator duke e mos arritur në rezultate të sakta dhe gjithëpërfshirëse.

Në total, indeksi përfshin 10 indikatorë të shpërndarë në këto tre dimensione, të përzgjedhur mbi bazën e relevancës së tyre në matjen e privimit energjetik. Kjo strukturë është në përputhje me qasjet e përdorura në literaturën ndërkombëtare, ku varfëria energjetike trajtohet si rezultat

13

[Multidimensional Poverty Measurement and Analysis](#)

i ndërveprimit midis cilësisë së banesës, aksesit në energji dhe kushteve socio-ekonomike të familjeve¹⁴.

Tabelë 2 Lista e indikatorëve të analizuar

Indikatorët	Përkufizimi	Kodi 1 (Privim)	Kodi 0 (Jo privim)
Cilësia e izolimit	Vlerëson nivelin e izolimit termik të banesës (mure, çati, dritare) dhe aftësinë për të ruajtur temperaturën e brendshme të ndërtesës.	Banesa nuk ka izolim termik	Banesa ka izolim termik
Mosha e ndërtesës	Përdoret si indikator për standardet e ndërtimit dhe eficiencën energjetike bazuar në vitin e ndërtimit	Ndërtesa e ndërtuar para pragut të përcaktuar, më shumë se 50 vjet	Ndërtesa e ndërtuar pas pragut të përcaktuar më shumë se 50 vjet.
Prania e rrjedhjeve/lagështirës	Vlerëson kushtet fizike të ndërtesës	Ka prani të dukshme të lagështirës, rrjedhjeve çatisë dhe myk.	Nuk ka prani të problemeve si myku, lageshtra
Aksesi në ngrohjes/ftohjes	Vlerëson nëse familja ka akses në pajisje ose sisteme për ngrohje në dimër dhe ftohje në verë	Mungesë aksesit në pajisje ose sisteme për ngrohje dhe ftohje	Akses në pajisje ose sisteme për ngrohje dhe ftohje
Lloji i energjisë për ngrohje	Identifikon burimin e energjisë të përdorur për ngrohje në banesë	Përdor burime jo të pastra ose jo efikase si: dru, gaz, qymyr.	Përdor burime si: energji elektrike
Lloji i energjisë për gatim	Identifikon burimin e energjisë të përdorur për gatim	Përdor burime jo të pastra ose jo efikase si: dru.	Përdor burime si: energji elektrike, gaz
Vonesa në pagesën e faturave	Mat aftësinë financiare të familjes për të përballuar kostot e energjisë	Ka vonesa të shpeshta në pagesën e faturave të energjisë (1-2 here, 3-5 here, Më shumë se 5 here)	Nuk ka pasur vonesa në pagesën e faturave të energjisë
Pjesa e të ardhurave të shpenzuara për energjinë	Tregon barrën financiare të energjisë ndaj të ardhurave totale të familjes	Shpenzimet për energji janë 10 – 30 % ose më shumë se 30 % e të ardhurave.	Shpenzimet për energji janë më pak se 10% e të ardhurave.
Asistenca sociale	Vlerëson nëse familja përfiton mbështetje sociale	Nuk përfiton asnjë formë asistence sociale	Përfiton asistencë sociale
Niveli i arsimit	Përdoret si indikator socio-ekonomik	Ka arsim 9-vjecare	Ka arsim të mesëm ose të lartë

Struktura e indeksit të varfërisë energjitiqe në shumë dimensionë dhe sistemi i peshimit

Indeksi IVED në këtë studim ndërtohet mbi tre dimensionë kryesore dhe 10 indikatorë në total. Për të siguruar një matje të balancuar, është aplikuar një sistem peshimi hierarkik, ku çdo dimension ka peshë totale të barabartë me 1, ndërsa indikatorët brenda çdo dimension ndajnë peshën përkatëse të tij në varësi të rëndësisë së indikatorit. Kjo ndarje reflekton parimin e

14

[Confronting Energy Poverty in Europe](#)

trajtimin të barabartë të fushave kryesore të varfërisë energjetike, në përputhje me praktikën standarde Iniciativës së Oksfordit për Varfërinë dhe Zhvillimin Njerëzor¹⁵.

Tabelë 3 Dimensionet dhe indikatorët e pëdorur për analizën e varfërisë energjetike në shumë dimensione

Dimensionet	Indikatorët	Pesha e Dimensioneve	Pesha e Indikatorëve
Kushtet e banesës	Cilësia e izolimit	0.4	0.2
	Mosha e ndërtesës		0.1
	Prania e rrjedhjeve/lagështirës		0.1
Përdorimi i Energjisë	Disponueshmëria e ngrohjes/ftohjes	0.3	0.1
	Lloji i energjisë për ngrohje		0.1
	Lloji i energjisë për gatimi		0.1
Kushte socio-ekonomike	Vonesa në pagesën e faturave	0.3	0.075
	Pjesa e të ardhurave të shpenzuara për energjinë		0.075
	Asistenca sociale		0.075
	Niveli i arsimit		0.075

Identifikimi i varfërisë energjetike realizohet përmes aplikimit të dy llojeve të kufinjve.

1- Kufiri i indikatorëve, të cilat përcaktojnë nëse një familje është e privuar në një indikator të caktuar, bazuar në një nivel minimal arritjeje të përcaktuar paraprakisht. Nëse familja është e privuar atëherë i korrespondon vlera '1' nëse jo vlera '0'.

2-Më pas vlerësimi bazohet tek cdo dimension për të parë në sa dimensione është i privuar i anketuari.

3-Rezultati: Kufiri i varfërisë(k), përcakton numrin minimal të privimeve të peshuara që një familje duhet të ketë për t'u konsideruar e varfër energjetikisht. Sipas literaturës nëse rezultati i privimit është më i madh ose i barabartë me 0.3, familja klasifikohet si e varfër energjetikisht. Procesi analitik fillon me ndërtimin e një matrice privimi, në të cilën çdo familje vlerësohet në raport me çdo indikator. Matrica është binare, ku vlera 1 tregon ekzistencën e privimit, ndërsa vlera 0 tregon mungesën e tij. Për çdo familje llogaritet rezultati i privimit i cili përfaqëson shumën e privimeve të peshuara në të gjithë indikatorët e përfshirë në analizë. Ky tregues pasqyron shkallën totale të cenueshmërisë energjetike dhe shërben si bazë për klasifikimin e familjeve në raport me kufirin e varfërisë k. Matja e varfërisë energjetike realizohet përmes tre treguesve kryesorë të metodologjisë AF: incidenca (H), e cila mat numrin e familjeve të varfra (Sa janë të varfër nga aspekti energjetik?), intensiteti (A) (Sa të varfër janë?) i cili mat ashpersinë e privimeve të përjetuara nga familjet e varfra dhe indeksi IVED (Mo), i cili përfaqëson produktin e dy treguesve të parë ($M_o = H \times A$), duke reflektuar si përhapjen ashtu edhe intensitetin e varfërisë energjetike.

5. Rezultatet

5.1. Tipologjite familjare dhe karakteristikat a banesave

Në këtë studim është përdorur gjithashtu qasja e analizën bazuar në tregues të vetëm (për të kuptuar më mirë kontekstin e varfërisë energjetike në bashkitë Memaliaj dhe Selenicë, duke u fokusuar në indikatorët që nuk janë përfshirë në llogaritjen e indeksit të varfërisë energjetike

15

[Oxford Poverty and Human Development Initiative](#)

në shumë dimensione. Kjo na ndihmon në evidentimin më të qartë të karakteristikave specifike të privimit energjetik në nivel familjar dhe shërben si një plotësim i rëndësishëm për interpretimin e rezultateve të përgjithshme të studimit. Rezultatet e mëposhtme paraqesin gjetjet kryesore nga monitorimi i varfërisë energjetike i realizuar në bashkitë Memaliaj dhe Selenicë, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve në nivel familjar. Analiza përfshin disa nga indikatorët kryesorë që ndikojnë në këtë fenomen, si madhësia e familjes, kushtet e banimit, niveli i punësimit, si dhe përballueshmëria dhe kostot e energjisë.

Në Bashkinë Memaliaj, dominojnë familjet e vogla dhe mesatare (60 familje me 1–3 anëtarë kundrejt 41 me ≥ 4 anëtarë), kjo tregon një kërkesë relativisht më të ulët për energji. Kushtet e banimit janë të balancuara (70 familje në 2–5 dhoma, 21 në 1 dhomë, 9 në >5 dhoma), duke favorizuar një përdorim më efikas të energjisë. Megjithatë, problemi kryesor mbetet punësimi: 88 familje pa asnjë të punësuar, kundrejt një numri shumë të kufizuar me të ardhura, gjë që rrit ndjeshëm rrezikun e varfërisë energjetike.

Në Bashkinë Selenicë, mbizotërojnë familjet më të mëdha (61 familje me ≥ 4 anëtarë kundrejt 40 me 1–3 anëtarë), duke rritur kërkesën për energji. Shumica jeton në banesa me kapacitet mesatar (90 familje në 2–5 dhoma), të cilat shpesh janë të mbingarkuara për shkak të madhësisë së familjes. Ndërkohë, niveli i punësimit është relativisht më i lartë se në Memaliaj (59 familje me 1 të punësuar, 13 me 2, dhe 28 pa asnjë), por ky avantazh zbehet nga kërkesa më e madhe energjetike e familjeve të mëdha.

Tabelë 4 Struktura familjare dhe kushtet e banimit në Memaliaj dhe Selenicë

	Sa persona jetojnë në shtëpinë tuaj?	
	Memaliaj	Selenicë
1 person	10	5
2 persona	29	16
3 persona	21	19
4 persona	24	34
5 persona	10	19
Më shumë se 5 persona	7	8
	Sa dhoma ka shtëpia juaj?	
	Memaliaj	Selenicë
1 dhomë	21	11
2-5 dhoma	70	90
Me shume se 5 dhoma	9	0
	Sa persona punojnë në familjen tuaj?	
	Memaliaj	Selenicë
1 person	10	59
2 persona	3	13
4 persona	0	1
Asnje	88	28

Sa i përket nivelit të të ardhurave mujore, në Bashkinë Memaliaj evidentohet një përqendrim i lartë i familjeve në kategorinë me të ardhura shumë të ulëta: **67 familje raportojnë të ardhura nën 28000 Lekë** ndërsa vetëm **8 familje** deklarojnë të ardhura midis **28000–66000 Lekë**, dhe asnjë familje mbi këtë nivel. Një pjesë jo e vogël (**26 familje**) nuk kanë dhënë informacion mbi të ardhurat, kjo mund të reflektojë pasiguri ekonomike. Në Bashkinë Selenicë shpërndarja e të

ardhurave është më e larmishme: 38 familje janë nën **28000 Lekë**, 57 familje në intervalin **28000–66000 Lekë** dhe 7 familje mbi **66000 Lekë**, duke sugjeruar një nivel disi më të qëndrueshëm ekonomik krahasuar me bashkinë Memaliaj. Në lidhje me përballueshmërinë e kostove të energjisë elektrike, të dhënat tregojnë se në të dyja bashkitë shumica e familjeve përballen me fatura mujore në intervalin **2000–3000 lekë (65 familje në Memaliaj dhe 67 në Selenicë)**. Një numër i konsiderueshëm familjesh raportojnë gjithashtu fatura më të larta, në intervalin **4000–5000 lekë** (29 në Memaliaj dhe 33 në Selenicë), ndërsa një pjesë më e vogël paguajnë mbi **5000 lekë (7 në Memaliaj dhe 2 në Selenicë)**.

Tabelë 5 Të ardhurat & kostot e energjisë për bashkinë Memaliaj dhe Selenicë


	Cilat janë të ardhurat mujore të familjes suaj?	
	Memaliaj	Selenicë
Më pak se 28000 lekë	67	38
28000–66000 lekë	8	57
Më shumë se 66000 lekë	0	7
Nuk e di	26	0
	Sa është fatura e energjisë elektrike që paguani mesatarisht në muaj?	
	Memaliaj	Selenicë
2000-3000 lekë	65	67
4000-5000 lekë	29	33
Më shumë se 5000 lekë	7	2

5.2 Vlerësimi i Varfërisë Energjetike përmes IVED

5.2.1 Bashkia Memaliaj

Në këtë kapitull paraqitet analiza e Indeksit të Varfërisë Energjetike në shumë dimensionë duke vlerësuar si përhapjen ashtu edhe intensitetin e varfërisë energjetike në secilën bashki. Analiza bazohet në identifikimin e privimeve në çdo indikator kyç të lidhura me aksesin dhe përdorimin e energjisë, kushtet e banesës dhe socio-ekonomike. Përmes këtij vlerësimi evidentohen dallimet ndërmjet bashkive, grupeve më të prekura dhe dimensionet që ndikojnë më shumë në nivelet e varfërisë energjetike. Shpërndarja empirike e statusit të privimit sipas indikatorëve të përzgjedhur evidenton nivele të konsiderueshme të privimit në dimensionet kyçe të varfërisë energjetike. Indikatorët që lidhen me kushtet e banesës dhe aksesin në energji paraqesin përqindje shumë të larta të individëve të privuar. Rezultatet tregojnë që nga cilësia e dobët e izolimit janë të privuar rreth 100% e të anketuarëve, mungesa e kushteve adekuate për ngrohje/ftohje (afërsisht 40%), si dhe prania e lagështirës/rjedhjeve (rreth 73%). Këto rezultate tregojnë një deficit të theksuar infrastrukturor, i cili ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien termike dhe standardin e jetesës. Indikatorët ekonomikë konfirmojnë barrën e lartë financiare të energjisë mbi familjet. Përqindja e individëve që përjetojnë vonesa në pagesën e faturave është e lartë (rreth 50%), ndërsa një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave dedikohet për shpenzime energjetike (mbi 90%). Variablat që lidhen me burimet e energjisë (si lloji i energjisë për ngrohje dhe gatim) paraqesin një shpërndarje më të balancuar, ku niveli i privimit varion rreth 30–45%, duke reflektuar një diversifikim relativ të burimeve energjetike në nivel familjar. Po ashtu, indikatorët socialë si asistencë sociale (rreth 64%) dhe niveli i arsimit (rreth 72%) shfaqin nivele më të moderuara të privimit, duke sugjeruar se, në këtë kontekst, varfëria


energjetike është më e lidhur me kushtet fizike të banimit dhe presionin ekonomik sesa me faktorët tradicionalë socio-demografikë.



Grafik 6 Shpërndarja e individëve jo të privuar dhe të privuar sipas indikatorëve, Bashkia Memaliaj

Treguesit kryesorë të varfërisë energjetike në shumë dimensione

Treguesit e Indeksit të Varfërisë Energjetike në shumë dimensione, përfshijnë incidenca (**H**), intensiteti (**A**) dhe vlera e përgjithshme e indeksit (**IVED**), paraqesin një marrëdhënie funksionale dhe të ndërlidhur, ku secili ndikon drejtpërdrejt në interpretimin e fenomenit. Incidenca mat numrin e familjeve që janë të varfër nga aspekti energjetik ndërsa intensiteti vlerëson nivelin e ashpërsisë të këtyre privimeve ose shkallën e varfërisë tek familjet e prekura. Si rrjedhojë, rritja e numrit të familjeve të privuara ose shtimi i privimeve brenda tyre reflektohet në rritjen e vlerës së përgjithshme të indeksit, pasi IVED llogaritet si produkt i këtyre dy komponentëve. $MEPI = H \times A$. Treguesit nuk duhen interpretuar të veçuar, por si pjesë e një strukture analitike që evidenton si shtrirjen ashtu edhe ashpërsinë e varfërisë energjetike në popullsinë e studiuar.




Grafik 7 Treguesit e IVED, Bashkia Memaliaj

Rezultatet e paraqitura në grafik për bashkinë Memaliaj evidentojnë tre komponentët themelorë të indeksit të varfërisë energjetike në shumë dimensionale: Incidenca (H), Intensiteti (A) dhe vlera përfundimtare e IVED. Vlera $H = 0.99$ nënkupton se 99% e familjeve të përfshira në studim përjetojnë varfëri energjetike në shumë dimensione (në më tepër se 1 dimension). Ky është rezultat i lartë dhe tregon se varfëria energjetike nuk është fenomen marginal apo i izoluar, por një problem pothuajse universal në zonën e studimit, që do të thotë se pothuajse të gjitha familjet përballen me mungesa në një ose më shumë dimensione të aksesit, përballueshmërisë, cilësisë ose përdorimit të energjisë. Sipas studimit “Vështrime Globale bazuar në Indeksin Shumëdimensional të Varfërisë Energjetike”¹⁶, intensitet mbi 0.5 konsiderohet tregues i varfërisë mesatare, ndërsa vlera mbi 0.7 tregojnë intensitet të lartë të varfërisë. Vlera e intensiteti 0.702 do të thotë se familjet e klasifikuara si të varfra energjetikisht përjetojnë ashpërsi të lartë të varfërisë energjetike. Ky është një nivel i lartë dhe tregon se privimi nuk është sporadik apo i kufizuar në një indikator të vetëm, por është i shumëfishtë dhe sistematik. Indeksi i varfërisë energjetike në shumë dimensione sintetizon njëkohësisht shtrirjen dhe ashpërsinë e varfërisë energjetike në nivel familjar. Në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga Sabina Alkire dhe James Foster, ky indeks ndërtohet mbi identifikimin e privimeve në disa dimensione të lidhura me kushtet e banesës, përdorimin e energjisë dhe kushtet socio-ekonomike, kapërcyer kufizimet e matjeve tradicionale njëdimensionale të bazuara vetëm në të ardhura ose shpenzime. Vlera 0.70 (70%) paraqet një nivel shumë të lartë të varfërisë energjetike në shumë dimensione.

16

[Global Insights Based on the Multidimensional Energy Poverty Index](#)

Kontributi i dimensioneve në IVED



Grafik 8 Kontributi i dimensioneve, Memaliaj


Kontributi i dimensioneve në kuadrin e metodologjisë së Alkire–Foster përfaqëson peshën relative që secili dimension ka në varfërinë energjetike në shumë dimensione të matur përmes indeksit IVED. Kjo tregon se në cili dimension të varfërisë energjetike komunitetet janë më të prekura, duke ofruar një kuptim më të thelluar të strukturës së privimeve dhe jo vetëm të nivelit të përgjithshëm të varfërisë. Rezultatet e paraqitura tregojnë se dimensionin **Kushtet e banesës** ka kontributin më të lartë, me **45%**, që do të thotë se ky është dimensionin që ka ndikimin më të lartë mbi nivelin e varfërisë energjetike. Kjo tregon se cilësia e banesës, përfshirë izolimin termik, kushtet strukturore dhe infrastruktura bazë, luajnë një rol dominues në përjetimin e varfërisë energjetike. Dimensionin mbi **kushtet socio-ekonomike** kontribuon me **30%**, duke treguar se një pjesë e varfëria energjetike lidhet me kufizimet ekonomike të familjeve si niveli i punësimit, të ardhurat, etj. Dimensionin “**Aksesi në energji**”, me një kontribut prej **25%**, paraqet peshën më të ulët në strukturën e IVED. Ky rezultat tregon se, ndonëse komunitetet mund të kenë në një masë të caktuar akses formal në burime energjie, problemet që lidhen me këtë dimension nuk janë plotësisht të adresuara. Pra, edhe në rastet kur infrastruktura bazë ekziston, familjet mund të përballen me ndërprerje të shpeshta, kapacitete të kufizuara apo kosto që e bëjnë aksesin jo plotësisht funksional.

Fakti që ky dimension ka një kontribut më të ulët krahasuar me dimensionet e tjera tregon gjithashtu se varfëria energjetike në këtë kontekst nuk është e dominuar nga mungesa absolute e aksesit, por më tepër nga faktorë të lidhur me cilësinë e jetesës dhe kapacitetet ekonomike.

5.2.2 Bashkia Selenicë

Analiza e shpërndarjes së individëve sipas statusit të privimit (0 = jo të privuar; 1 = të privuar) në indikatorët e përzgjedhur tregon një strukturë të qartë të privimit në shumë dimensione, ku dimensionet që lidhen me kushtet e banesës dhe përdorimin e energjisë paraqiten si më të theksuara krahasuar me ato socio-ekonomike. Nga analiza kuptohet që indikatorët që lidhen me cilësinë e banesës paraqesin nivele shumë të larta të privimit. **94% e individëve** rezultojnë

të privuar për sa i përket cilësisë së izolimit, ndërsa vetëm 6% klasifikohen si jo të privuar. Një prije e ngjashme vërehet edhe për praninë e lagështirës apo rrjedhjeve, ku rreth 88% e individëve janë të privuar, si dhe për disponueshmërinë e sistemeve të ngrohjes dhe ftohes, ku privimi arrin në afërsisht 96%. Këto përqindje tregojnë problematika strukturore që lidhen me cilësinë e stokut të banesave dhe nivelin e ulët të efikasitetit energjetik. Në aspektin e përdorimit të energjisë, dallimet midis indikatorëve janë më të theksuara. Për energjinë e përdorur për ngrohje, shpërndarja është pothuajse e balancuar, me rreth 47% të individëve të privuar dhe 55% jo të privuar. Megjithatë, për energjinë e përdorur për gatim, situata është ndryshe, ku rreth 83% e individëve janë të privuar. Ky kontrast nënvizon kufizime më të theksuara në këtë dimension, duke reflektuar mungesë të alternativave më efikase energjetike. Vonesat në pagesën e faturave prekin rreth 89% të individëve të klasifikuar si të privuar, ndërsa vetëm 13% rezultojnë pa këtë problem. Njëkohësisht, rreth 88% e individëve përballen me një peshë të lartë të shpenzimeve për energjinë në raport me të ardhurat e tyre. Këto të dhëna janë tipike për një situatë të varfërisë energjetike, ku familjet jo vetëm që kanë vështirësi në përballimin e kostove, por edhe rrezikojnë të kufizojnë konsumin bazë për shkak të këtyre kufizimeve financiare.




Grafik 9 Shpërndarja e individëve jo të privuar dhe të privuar sipas indikatorëve, Bashkia Selenicë

Treguesit kryesorë të varfërisë energjetike në shumë dimensione


Rezultatet e paraqitura në grafik për Bashkinë Selenicë evidentojnë një nivel jashtëzakonisht të lartë të varfërisë energjetike nga shumë idimensione, si në aspektin e përhapjes së saj në popullatë, ashtu edhe në intensitetin (ashpërsinë) e privimeve që përjetohen. Incidenca e varfërisë (H) tregon se rreth 98% e individëve në Bashkinë Selenicë klasifikohen si të varfër. Kjo nënkupton se pothuajse e gjithë popullsia e marrë në studim përjeton një nivel të konsiderueshëm privimi në një ose më shumë dimensione. Vlera e intensitetit 0.74 tregon ashpërsi të lartë të përhapjes së varfërisë energjetike në shumë dimensione. Ky nivel i lartë intensiteti reflekton një situatë ku familjet nuk përballen vetëm me një mungesë të vetme, por me ndërthurje të privimeve në dimensione të ndryshme si kushtet e banimit, aksesin në energji dhe kushtet socio-ekonomike. Indeksi i varfërisë energjetike në shumë dimensione

paraqitet gjithashtu në një nivel shumë të lartë. Duke qenë se ky indeks sintetizon njëkohësisht shtrirjen dhe intensitetin e varfërisë ($IVED = H \times A$), vlera 72% e tij konfirmon praninë e një varfërie energjitike të ashpër në Bashkinë Selenicë.



Grafik 10 Treguesit e IVED, Bashkia Selenicë

Kontributi i dimensioneve në IVED



Grafik 11 Kontributi i dimensioneve, Selenicë

Rezultatet tregojnë se dimensionin “**Kushtet e banesës**” mbetet dominues, duke kontribuar me 46% në indeksin IVED. Kjo nënvizon se problematikat që lidhen me cilësinë e banimit, si izolimi termik, moshës së ndërtesës dhe pranisë së mykut dhe lagështirës, janë faktorët kryesorë që ndikojnë në kushtet e ulëta termike të banesës.

Dimensioni “**Akresi në energji**” përfaqëson një kontribut prej **30%**, duke reflektuar sfida të konsiderueshme në lidhje me furnizimin dhe përdorimin efektiv të energjisë. Ky rezultat tregon se, përtej ekzistencës së infrastrukturës bazë të furnizimit me energji, mbeten të pranishme kufizime që lidhen me kostot. Për më tepër ndër faktorët, që ndikojnë në aksesin në energji janë disponueshmëria mbi sistemet e ngrohjes/ftohjes, lloji dhe teknologjite për ngrohje dhe gatim. Dimensioni “**Kushtet socio-ekonomike**” paraqet kontributin më të ulët, me **24%**, por mbetet gjithsesi një komponent i rëndësishëm i varfërisë energjetike. Ky rezultat tregon ndikimin e faktorëve ekonomikë, si të ardhurat dhe mundësia për të përballuar kostot e energjisë.

5.3. Krahasimi i treguesve të varfërisë energjetike në shumë dimensione me literature ndërkombëtare

Krahasimi i treguesve të llogaritur për bashkitë Selenicë dhe Memaliaj me standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara dhe Iniciativa e Oksfordit për Varfërinë dhe Zhvillimin Njerëzor ¹⁷ evidenton një devijim të theksuar nga shpërndarjet tipike globale të varfërisë shumëdimensionale. Ndërkohë që literatura ndërkombëtare raporton se vlerat e indeksit IVED zakonisht variojnë brenda intervalit 0.05–0.30 dhe vetëm në raste të veçanta tejkalojnë pragun 0.40, rezultatet për Selenicën (IVED = 0.72) dhe Memaliaj (IVED = 0.69) paraqiten dukshëm më të larta. Ky devijim nuk reflekton vetëm një përhapje të gjerë të varfërisë ($H = 0.98$ në të dy bashkitë), por edhe një intensitet të lartë të privimeve ($A > 0.70$), duke treguar praninë e një forme të varfërisë shumëdimensionale të thellë dhe strukturore. Sipas qasjes metodologjike të zhvilluar nga Sabina Alkire dhe James Foster, vlera të tilla të intensitetit janë indikative të akumulimit të privimeve në disa dimensione njëkohësisht, fenomen që shpesh lidhet me disavantazhe territoriale, izolim gjeografik dhe kufizime në aksesin ndaj shërbimeve bazë.

Tabelë 6 Treguesit e indeksit të varfërisë energjetike për bashkitë e marra në studim dhe vlerat referencë

Treguesi	Memaliaj	Selenicë	Vlerat referencë	Interpretimi i vlerave referencë
Incidenca (H)	0.99	0.98	0.05-0.6	Nivele të ulëta deri në moderuara të përhapjes së varfërisë energjetike
Intensiteti (A)	0.70	0.74	0.30 – 0.60	Ashpërsi mesatar deri në të lartë e varfërisë energjetike
IVED	0.70	0.72	>0.40	Nivele të larta të varfërisë energjetike

Tabelë 7 Vlerat referencë të indeksit të varfërisë energjetike për Ballkanin

Shteti	Incidenca (H)	Intensiteti (A)	IVED (MPI = H*A)
Serbia	0.65	0.42	0.273
Mali i Zi	0.39	0.38	0.1482
Bosnje Hercegovina	2.07	0.38	0.7866
Shqipëria	0.69	0.40	0.276


Bazuar në të dhënat e Iniciativës së Oksfordit për Varfërinë dhe Zhvillimin Njerëzor, ofrohet një perspektivë krahasuese të strukturuar mbi Shqipërinë në raport me Serbinë, Malin e Zi dhe

17

[Unstacking global poverty: Data for high-impact action](#)

Bosnje dhe Hercegovinë. Në tabelën mësipër janë paraqitur vlerat e treguesve të varfërisë energjitike në shumë dimensione për zonat rurale. Shqipëria paraqet një profil të ndërmjetëm rajonal. Incidenca e varfërisë (H) në zonat rurale shqiptare është dukshëm më e ulët se në Bosnje dhe Hercegovinë, e cila shfaq nivelin më të lartë në kampion, por mbetet e krahasueshme me Serbinë dhe më e lartë se në Malin e Zi. Sa i përket intensitetit të varfërisë (A), Shqipëria paraqet vlera të ngjashme me vendet e tjera të rajonit, me diferenca minimale ndërmjet tyre. Ky konstatim implikon se familjet e konsideruara energjitikisht të varfra në Shqipëri përjetojnë nivele të krahasueshme privimesh me ata në Serbi, Mal të Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinë, duke treguar homogjenitet në thellësinë e varfërisë në nivel rajonal. Nivel IVED për Shqipërinë që është më i ulët se ai i Bosnje dhe Hercegovinës, por më i lartë se në Malin e Zi dhe afërsisht i njëjtë me Serbinë. Kjo e pozicionon Shqipërinë në një zonë mesatare të performancës rajonale, duke reflektuar një ekuilibër midis përhapjes dhe intensitetit të varfërisë. Rezultate tregojnë se sfida kryesore për Shqipërinë lidhet më me incidencën e varfërisë dhe me intensitetin (ashpërsinë) e saj. Sipas të dhënave zonat rurale në Shqipëri karakterizohet nga një model i “varfërisë së përhapur me intensitet të moderuar”, në kontrast me Bosnje dhe Hercegovinë ku dominon një kombinim më i lartë i përhapjes dhe rezultatit total (IVED).

Referuar studimeve të zhvilluara për Shqipërinë, indeksi kombëtar i varfërisë energjitike është konsideruar 0.276 që janë nivele mesatare të varfërisë energjitike. Kryesisht, këto të dhëna i referohen më tepër zonave urbane ku edhe niveli i varfërisë energjitike është më i ulët. Më poshtë janë përshkruar gjetjet në zonat e targetuara gjë e cila tregon dhe diferencën e qartë ndërmjet zonave urbane dhe atyre rurale.



Grafik 12 Vlerat e treguesve të indeksit të varfërisë energjitike në shumë dimensione

Krahasimi i rezultateve të Bashkisë Selenicë dhe Bashkisë Memaliaj me vlerat referente për zonat rurale të Shqipërisë të paraqitura në (Tabelë nr 12) evidenton se të dy njësitë vendore paraqiten një situatë më të pafavorshme sa i përket varfërisë energjetike. Ndërsa niveli mesatar i Shqipërisë rurale karakterizohet nga një incidencë dhe intensitet i moderuar i privimeve energjetike, të dhënat e mbledhura në këto dy bashki tregojnë vlera dukshëm më të larta të indeksit total IVED. Kjo nënkupton se familjet e përfshira në studim ekspozohen më shumë ndaj kushteve të mungesës energjetike dhe përjetojnë një kombinim më të gjerë privimesh krahasuar me mesataren kombëtare. Në aspektin e incidencës (H), si Selenica ashtu edhe Memaliaj rezultojnë mbi nivelin mesatar të Shqipërisë rurale, duke treguar se përqindja e familjeve të prekura nga varfëria energjetike është më e lartë në këto territore.

Ky konstatim sugjeron se problematika në këto bashki nuk është fenomen i izoluar, por prek një segment më të gjerë të popullsisë vendase. Në mënyrë të veçantë, fakti që incidenca paraqitet kaq e lartë tregon praninë e kufizimeve strukturore që lidhen me kushtet e banimit, aksesin ndaj energjisë dhe kapacitetin ekonomik të familjeve për të përballuar nevojat bazë energjetike. Të dy bashkitë paraqesin nivele të intensitetit (A) mbi mesataren kombëtare, kjo tregon se familjet e identifikuar si të varfra energjetikisht nuk me disa privime të ndërthurura njëkohësisht. Vlerat e IVED në Selenicë dhe Memaliaj tejkalonë ndjeshëm nivelin referues kombëtar sipas studimit nga OPHI (2024).

Kjo tregon se mesatarja rurale e Shqipërisë nuk pasqyron plotësisht pabarazitë territoriale që ekzistojnë brenda vendit. Përkundrazi të dhënat tregojnë se brenda hapësirës rurale shqiptare ekzistojnë zona me cenueshmëri dukshëm më të lartë, ku varfëria energjetike merr formë më intensive dhe më të përhapur. Në këtë kuptim bashkia Selenicë dhe Memaliaj përfaqësojnë raste që dëshmojnë nevojën për analiza të detajuara nënkombëtare dhe për politika lokale të targetuara, të orientuara sipas specifikave territoriale dhe socio-ekonomike të secilës zonë.

6. Konkluzionet dhe rekomandimet

Rezultatet e studimit tregojnë se varfëria energjetike në Bashkitë Memaliaj dhe Selenicë paraqitet në nivele shumë të larta, si në aspektin e përhapjes ashtu edhe të intensitetit të varfërisë energjetike. Analiza e realizuar përmes Indeksit të Varfërisë Energjetike në Shumë Dimensione (IVED) tregon se incidenca e varfërisë energjetike arrin në 99% në Bashkinë Memaliaj dhe 98% në Bashkinë Selenicë, kjo tregon se pothuajse e gjithë popullsia e përfshirë në studim përjeton privime energjetike në më shumë se një dimension.

Analiza sipas dimensioneve tregon se kushtet e banesës përbëjnë faktorët kryesorë që ndikojnë në nivelin e varfërisë energjetike, me një kontribut prej 45% në Memaliaj dhe 46% në Selenicë. Problematikat më të theksuara lidhen me mungesën e izolimit termik, praninë e lagështirës, amortizimin dhe moshën e ndërtesave, faktorë që ndikojnë drejtpërdrejt në humbjet e energjisë dhe në pamundësinë për të siguruar kushte minimale të komfortit termik. Njëkohësisht, rezultatet tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e familjeve përballen me vështirësi në përballimin e kostove të energjisë, ku një pjesë e lartë e të ardhurave mujore shpenzohet për energjinë elektrike dhe ngrohjen.

Rekomandimet e shprehura nga familjet reflektojnë qartë nevojat e tyre konkrete dhe emergjente. Në thelb, ato kërkojnë ndërhyrje që lidhen me:

Komponenti 1: Përmisimi i kushteve të banesës

- Përmirësimin e efikasitetit të energjisë të banesave përmes izolimit termik;
- Riparimin e çatave dhe eliminimin e lagështirës;
- Zëvendësimin e dritareve dhe dyerve për të reduktuar humbjet e energjisë;
- Zëvendësimin e pajisjeve elektrike të vjetra me alternativa më efikente;
- Përdorimin e burimeve alternative të energjisë, si panelet diellore;
- Nxjitja e granteve dhe incentivave nga pushteti vendor për aksesin në investime konkrete mbi rehabilitimin e ndërtesave.

Komponenti 2: Aksesin në energji

- Mbështetja financiare nëpërmjet granteve lokale për zëvendësimin e sobave me drurë me soba më efikente/kondicionerëve për ftohje, panelet diellore për energji elektrike dhe ngrohje;
- Krijimi i komuniteteve të energjisë në nivel lokal për akses në energji për ngrohje dhe energji elektrike;
- Investimet në rrjetin e shpërndarjes së energjisë duke krijuar siguri dhe furnizim të qëndrueshëm të energjisë;

Komponenti 3: Kushtet socio-ekonomike

- Edukimi dhe informimi i popullsisë lokale mbi masat që duhet të ndërmerren për reduktimin e konsumit të energjisë;
- Mbështetja financiare e komuniteteve lokale për përballimin e kostove të energjisë.
- Perjashtimi nga TVSH/skema ndihmuese për fermerët që merren me bujqësi dhe që janë bazuar në konsumin e energjisë;
- Mbështetja me shërbim mjekësor dhe monitorimi i vazhdueshëm i grupeve vulnerabël;

7. ANEKS 1: Moduli per monitorimin dhe analizën e varferisë energjike

PYETËSOR VARFËRIA ENERGIJITIKE

Ky pyetësor zhvillohet në kuadër të projektit “EnerPoëer: Nxitja e nismave lokale për të ulur varfërinë energjitike në komunitetet vulnerabël”, i cili zbatohet nga Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit (ETMI) në bashkëpunim me CELIM Shqipëri dhe Gjellbërimi 2000, financiar nga Projekti GreenAL “Mbështetja e Organizatave të Shoqërisë Civile 2024 - 2027”, Qëllim i pyetësorit është vlerësimi i nivelit të varfërisë energjetike në dy bashki të përzgjedhura, Selenicë dhe Memaliaj, përmes një procesi gjithëpërfshirës që angazhon qytetarët dhe komunitetet lokale. Të dhënat e mbledhura do të ndihmojnë në hartëzimin e varfërisë energjetike, identifikimin e nevojave kryesore të familjeve vulnerabël, dhe në përgatitjen e masave lokale për zbutjen e feneomenit.

Të dhëna demografike

1. Cila është gjinia juaj?

☐ Mashkull ☐ Femër

2. Cili është niveli juaj arsimor?

☐ 9-vjecar ☐ I mesëm ☐ I lartë

3. Në cilën lagje/fshat/njësi administrative jetoni?

3. Cfare lloj ndertese jetoni?

☐ Shtëpi e vecuar ☐ Apartament ☐ Shtëpi në rresht ☐ Shtëpi gjysme e vecuar

Seksioni 1: Karakteristikat e ndërtesës dhe performanca energjitike (Dimensioni ndertese)

Statusi i pronës dhe numri i dhomave

5. Cili është statusi i pronës tuaj?

☐ Me qira ☐ Shtëpi në private

6. Sa persona jetojnë në shtëpinë tuaj?

☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5 ☐ Më shumë se 5

7. Sa është sipërfaqja e banesës suaj?

☐ Më pak se 40 m² ☐ 40–60 m² ☐ 61–80 m² ☐ Mbi 80 m²

8. Sa dhoma ka shtëpia juaj?

☐ 1 ☐ 2-5 ☐ Më shumë se 5

9. A janë të ngrohta/fresketa të gjitha ambientet e shtëpise sipas stinës?

☐ Po ☐ Jo

Pamundësia për të mbajtur shtëpinë mjaftueshëm ngrohtë/Ftohtë

10. A ka izolim termik shtëpia juaj?

☐ Po ☐ Jo ☐ Nuk e di

11. Cila është vjetërsia e ndërtesës ku jetoni?

☐ Më pak se 25 vjet ☐ 25 - 45 vjet ☐ Më shumë se 50 vjet

12. Sa të kënaqur jeni me izolimin e dyerve dhe dritareve/dyshemese?

☐ Shumë i/e pakënaqur ☐ I/E pakënaqur ☐ Neutral ☐ I/E kënaqur ☐ Shumë i/e kënaqur

13. Sa te kënaqur jeni me efencen energjetike të pajisjeve tuaja?

☐ Shumë I/e pakënaqur ☐ I/E pakënaqur ☐ Neutral ☐ I/E kënaqur ☐ Shumë i/e kënaqur

14. A e shmanjni përdorimin e pajisjeve me konsum të lartë për te kursyer energji?

☐ Po ☐ Jo

15. A e keni rinovuar ndertesen 10 vitet e fundit?

☐ Po ☐ Jo

Nese po, sa here? _____

16. A mendoni që sasia e energjise që përdorni përmbush nevojat e juaja për ngrohje/ftohje?

☐ Po ☐ Jo

Sistemet e ngrohjes

17. Çfarë sistemi ngrohjeje përdorni në shtëpinë tuaj?

☐ Ngrrohje me gaz ☐ Ngrrohje elektrike ☐ Ngrrohje me dru
☐ Ngrrohje me biomasë (kaldajë me pelet ose dru) ☐ asnje _____

18. Çfarë lloj burim energjie përdorni për ftohjen?

☐ Gaz ☐ Energji elektrike ☐ Energji të rinovueshme ☐ asnje (specifikoni) _____

19. Çfarë lloj burim energjie përdorni për gatim?

☐ Gaz ☐ Energji elektrike ☐ Drru ☐ Asnje ☐ Tjeter

20. Çfarë lloj burim energjie përdorni për ndricim?

☐ Energji elektrike ☐ Energji të rinovueshme ☐ Tjetër (specifikoni) _____

Sistemet e ajrit të kondicionuar

21. Sa dhoma në shtëpinë tuaj kanë ajër të kondicionuar?

☐ 0 ☐ 1 ☐ 2-3 ☐ 4-5 ☐ Më shumë se 5

22. Sa orë në ditë e mbani sistemin e ftohjes gjatë një dite vere?

☐ Më pak se 1 orë ☐ 1-2 orë ☐ 3-4 orë ☐ Më shumë se 4 orë

23. Sa orë në ditë e mbani sistemin e ngrohjes gjatë një dite dimri?

☐ Më pak se 1 orë ☐ 1-2 orë ☐ 3-4 orë ☐ Më shumë se 4 orë

24. A kufizoni përdorimin e kondicionerit për shkak të faturës së energjisë?

☐ Po ☐ Ndonjëherë ☐ Kurrë

Seksioni 2: Komforti termik dhe kushtet klimatike (Dimensioni Klime)

Komforti gjatë verës

25. Si i vlerësoni kushtet e jetesës në aspektin e komfortit gjatë stines së verës?

☐ Shumë I/e pakënaqur ☐ I/E pakënaqur ☐ Neutral ☐ I/E kënaqur ☐ Shumë i/e kënaqur

26. Cila është temperatura që mbani brenda shtëpisë tuaj gjatë verës?

☐ < 18°C ☐ 18°C – 24°C ☐ 25°C – 28°C ☐ 29°C – 35°C ☐ Nuk e di

27. Cila është fatura mujore më e lartë që keni paguar për energji në verë?

Komforti gjatë dimrit

28. A jeni të kënaqur/pakënaqur me banesën tuaj gjatë dimrit?

☐ Shumë I/e pakënaqur ☐ I/E pakënaqur ☐ Neutral ☐ I/E kënaqur ☐ Shumë i/e kënaqur

29. Cila është temperatura që mbani brenda shtëpisë gjatë dimrit?

☐ <15°C ☐ 15°C – 18°C ☐ 18°C - 22°C ☐ >22°C ☐ Nuk e di

30. Cila është fatura mujore më e lartë që keni paguar për energji në dimër?

Prania e lagështisë, rrjedhjeve dhe mykut në banesë

31. A keni ndonjë nga problemet e mëposhtme në banesën tuaj?

☐ Çati që pikon ☐ Mure/tokë/themele me lagështi ☐ Myk në kornizat e dritareve ose dysHEME ☐ Asnjë nga përgjigjet e mësipërme

Seksioni 3: Kushtet socio-ekonomike dhe përballueshmëria e energjisë (Dimensioni social-ekonomik)

Vonesa në pagesën e faturave

32. Gjatë 5 viteve të fundit, sa herë keni pasur vonesa në pagesën e faturës së energjisë?

☐ Asnjehere ☐ 1-2 here ☐ 3-5 here ☐ Më shumë se 5 here

Shpenzime të larta për energjinë në raport me të ardhurat

33. Sa persona punojnë në familjen tuaj?

☐ Asnje ☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5 ☐ Më shumë se 5

34. Cilat janë të ardhurat mujore të familjes suaj?

☐ Më pak se 300 € ☐ 300 – 700 € ☐ Më shumë se 700 € ☐ Nuk e di

35. Cila pjesa e të ardhurave familjare nevojitet për të mbuluar faturat e energjisë?

☐ Më pak se 10 % ☐ 10 – 30 % ☐ Më shumë se 30 % ☐ Nuk e di

36. Sa është fatura e energjisë elektrike që paguani mesatarisht në muaj? (opsionale)

☐ 2000-3000 lek ☐ 4000-5000 lek ☐ Më shumë se 5000 lek

Çmimi i energjisë elektrike dhe gazit natyror

37. Si e vlerësoni çmimin e energjisë elektrike për shtëpinë tuaj?

☐ I shtrenjtë ☐ Neutral ☐ I përballueshëm

38. Si e vlerësoni çmimin e gazit natyror për shtëpinë tuaj?

☐ I shtrenjtë ☐ Neutral ☐ I përballueshëm ☐ Nuk përdor gaz natyror

39. Si e vlerësoni çmimin e drurit për ngrohje për shtëpinë tuaj?

☐ I shtrenjtë ☐ Neutral ☐ I përballueshëm ☐ Nuk përdor gaz natyror

40. A kalon fatura e energjisë elektrike kufirin që ju mendoni se është e përballueshme për familjen tuaj?

☐ Po ☐ Ndonjehere ☐ Jo

Vështirësi ekonomike

41. A keni pasur vështirësi për të mbuluar shpenzimet bazë si qiraja ose ushqimi gjatë 5-viteve të fundit?



☐ Kurrë ☐ Shpesh ☐ Gjithmonë

42. A keni hequr dorë nga aktivitetet e përditshme për shkak të faturave të energjisë?

☐ Kurrë ☐ Shpesh ☐ Gjithmonë

43. A përfiton familja juaj nga ndihma ekonomike ose skema të tjera mbështetjeje sociale?

☐ Po ☐ Jo

44. Sa mendoni se varfëria energjitike ndikon në shëndetin e familjes suaj?

☐ Aspak ☐ Pak ☐ Shumë

45. Cila është gjëja që ju shqetëson më shumë në lidhje me energjinë?

46. Nëse do të mund të përmirësonit diçka në shtëpinë tuaj për ta bërë atë më efikase, çfarë do të ishte?



EnerPower

Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit “EnerPoëer:Nxitje e nismave lokale për të ulur varfërinë energjike në komunitet vunerabël”, me mbështetjen e GreenAL, projekt i cili zbatohet nga CoPlan, COSV dhe VIS Albania. Pikëpamjet dhe përfundimet e përfshira këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Suedeze ose të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim për Zhvillim (Sida).